



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:038766

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05466015

Ac.nr.2934/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. Xh. nga M., kundër të paditurës T. Sh.A., me seli në M., të cilën sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson A.V., zyrtar i lartë ligjorë, për shkak të kompensimit në emër të shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.224/2021, të datës 18.01.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.03.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit, I. Xh. nga M., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.224/2021, i datë 18.01.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.224/2021 të datës 18.01.2022, në pikën e parë të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit I. Xh. nga M., kundër të paditurës T. Sh.A., më seli në M., me të cilën ka kërkuar kompensimin në emër të shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse si të pa bazuar. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar secilën palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje apo që ta aprovojë kërkesëpadinë dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj tri paga jubilarë dhe tri përcjellëse në afat prej 15 ditësh na ditae plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E paditura nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit I. Xh. nga M., me datë 01.03.2021, ka ushtruar padi kundër të paditurës me të cilën ka kërkuar kompensimin në emër të shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse, duke u bazuar në nenin 90 të Ligjit të Punës dhe nenin 52 paragrafi 3 dhe neni 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i kërkoi.

Përfaqësuesi i të paditurës, gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për shkak të parashkrimit të kërkesës, pasi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka skaduar me datë 31.12.2017, dhe kanë kaluar më shumë se tri vite. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i kërkoi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka caktuar seancë gjyqësore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.224/2021 të datës 18.01.2022 me të cilin e refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata ka theksuar se nga vërtetimi i datës 14.12.2021, u konstatua që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të paditura nga datat 22.12.1999 deri me 05.07.2011 si sigurim fizik, kurse nga data 05.07.2011 deri me 16.08.2018 ka punuar në flotacion-Tunel i parë, deri në daljen në pension me datë 17.08.2018. Nga Ekstrakti nga lista e pagës e muajit dhjetorit të vitit 2017, lëshuar nga ProCredit Bank, vërtetohet se paga bazë të cilën e ka realizuar paditësi është shuma prej 704.37 euro. Paditësi, kërkesën për kompensimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar e ka mbështetur në nenin 52 dhe 53 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës si dhe nenit 90 të Ligjit të Punës. Në periudhën kur paditësi ka mbushur 10 vite përvojë më datë 22.12.2009, nuk ka qenë në fuqi marrëveshja e përgjithshme kolektive apo kontratë kolektive e cila do të përcaktonte detyrimin e të paditurës për pagesën e shpërblimit jubilar paditësit, kjo për arsye se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e cila ka qenë në fuqi nga data 01.01.2015 e deri më datë 31.12.2017, nuk përcakton aplikimin e dispozitave të saj në mënyrë retroaktive. Së këndejmi, e drejta në kompensimin e pagave për shpërblim jubilar në kuptimin material, krijohet gjatë kohës së Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, ka qenë në fuqi, andaj nga këto arsye Gjykata e vlerëson kërkesëpadinë e paditësit të pa bazuar. Tutje, paditësi sipas provave të administruara në këtë çështje juridike, i është pushuar marrëdhënia e punës më datë 08.08.2018, pas arritjes së moshës së pleqërisë, ndërsa padinë në Gjykatë e ka paraqitur më datë 03.01.2021, që i bie se paditësi të drejtën për kompensimin e pagave përcjellës për në pension e ka fituar më rastin e daljes në pension (08.08.2018), në kohën

kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka pushuar se vepruari. Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërtëhënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të paditësit për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon në tërësi qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe vërteton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, si rrjedhojë drejtë e ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Nga shkesat e lëndës, konkretisht nga vërtetimi i datës 14.12.2021, vërtetohet se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune tek e paditura me datë 22.12.1999 deri me datën 17.08.2018, ndërsa me datë 08.08.2018 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit iu është ndërpre marrëdhënie e punës.

Me dispozitat e nenit 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive*

duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 4 përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Po ashtu me nenin 52 paragrafi 1 pika 1.1 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës parashihet se *“I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij”*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe ligjor për arsye se: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës është aplikuar nga data 01.01.2015 deri me datën 31.12.2017, ndërsa paditësi ka themeluar marrëdhënien e punës me datë 12.12.1999 dhe se në kohën kur ka arritur vitin jubilar (10 vite përvojë pune), e që nga përlllogaritja matematikore i bie të jetë data 22.12.2009 nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e cila aplikohet nga data 01.01.2015 e deri me datën 31.12.2017 andaj për paditësin I. Xh. mungon baza ligjore për të realizuar kërkesëpadinë për shpërblim jubilar e po ashtu edhe kërkesëpadinë për paga përcjellëse ngase i njëjti u pensionua me datë 08.08.2018 kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka pushuar se prodhuari efekte juridike sipas fuqisë ligjore dhe se e njëjta më nuk është më në fuqi.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës t’ia kompensojë paditëses shumën prej 401.69 euro.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitatat nenit e 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2934/2022, datë 18.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Ardian Ajvazi